



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 42

Prishtinë, më 26.04.2016 në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, N- 302

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Slobodan Petrović, Xhavit Haliti, Luljeta Veselaj-Gutaj, Bislim Zogaj, Arben Gashi, Vjosa Osmani dhe Kujtim Paqaku.

Munguan: Valdete Bajrami, Ilir Deda dhe Time Kadrijaj.

Nga Staf mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha, Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi, zëvendëskryetari i dytë, z. Slobodan Petrović.

Në mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 22.3.2016 dhe 05.4.2016;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-061 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-055 për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

8. Të ndryshme.

Zëvendëskryetari i Komisionit, z. Slobodan Petrović, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 22.03.2016 dhe 05.04.2016

Kryesuesi i Komisionit pyeti anëtarët se a kanë vërejtje ne procesverbale.

Xhavit Haliti, kërkoi që në rastet kur deputetet gjenden ne udhëtime zyrtare, mos të shënohet në procesverbal vetëm mungon, por të shënohet edhe se gjendet në udhëtim zyrtar.

Procesverbalet e mbledhjeve të datave 22.03.2016 dhe 05.04.2016, u miratuan.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-061 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Zëvendëskryetari Slobodan Petrović, lidhur me përputhshmërinë e këtij projektligji me legjislacionin e BE-së, paraqiti opinionin ligjor.

Konstatojmë se Projektligji nr. 05/L-061 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, pasi që në nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe nuk është i rregulluar në mënyrë specifike me Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Në vazhdim hapi diskutimin.

Vjosa Osmani, theksoi se gjatë leximit të parë të këtij projektligji, kam paraqitur vërejtjet e mia dhe disa nga këto janë marrë parasysh nga Komisioni funksional, por ende ka probleme jashtëzakonisht të mëdha në këtë projektligj dhe do t'i përmend disa prej tyre.

1.Një shtet i ri duhet te ketë kujdes, që fushën e shërbimit te jashtëm dhe shërbimin e forcave ta mbajë të depolitizuar dhe të bëhet përpjekje mos të shkelen praktikat më të mira evropiane. Ajo çka po tentohet të bëhet me këtë ligj, sidomos në nenin 37, është të barazohen diplomatët e karrierës, me ata të emëruarit politik, gjë që nuk ka ndodhur deri më tani, sepse te diplomatët e shërbimit të karrierës, kërkohen të kalojnë disa trajnime dhe të kalojnë në gjitha strukturat në Ministrinë e Punëve të Jashtme, kurse për ata që janë të emëruar politikë, që fatkeqësisht shumica janë të emëruar të tillë, mjafton që ta bëjë një kërkesë drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, dhe pastaj ministri, nëse e konsideron që është në interes të Republikës Kosovës, të emëruarin politik, automatikisht e bën diplomat te karrierës, pa kaluar në fazat e përmendura. Kjo e politizon tejskajshëm shërbimin diplomatik.

Andaj, kërkoj nga stafi ynë, që të bëjë një hulumtim lidhur me praktikat më të mira evropiane, të vendeve të rajonit apo edhe ndonjë shtet që është pjesë e BE-së, si p.sh Sllovenia, të shohin se çfarë praktika kanë marrë ata parasysh. Nga shembujt që kam studiuar, të emëruarit politikë mbesin të emëruar politikë dhe nuk mund të shndërrohen automatikisht në diplomat të karrierës.

E dyta sa, i përket nenit 26, që ka të bëjë me të drejtat e anëtarëve të familjeve të ambasadorëve dhe diplomatëve tjerë. Duhet t'i kemi parasysh disa gjëra, sepse një ambasador paguhet diku 3 mijë € dhe i paguhet banesa dhe shumë shpenzime tjera, mirëpo tani po propozohet që bashkëshortja apo bashkëshorti, pa punuar fare, të paguhet me 50% të pagës së atasheut dhe fëmijët të marrin 20%. Kjo më duket e paarsyeshme, përderisa kemi problem me buxhet për barna esenciale dhe me buxhet për shumë kategori tjera, të cilat janë në skemat tjera sociale. Më duket e arsyeshme që bashkëshortëve t'u lejohet të punojnë, e jo të marrin paga, duke mos bërë asgjë nga ky buxhet, që është shumë i varfër. Gjykata Kushtetuese e ka vënë një standard në një vendim për pensionet e deputetëve dhe arsyeja themelore pse i ka refuzuar ato, ka qenë se ka konsideruar se propozimi i bërë nuk përkon me standardin social që ekziston në Kosovë. Pra, nëse ne miratojmë diçka të tillë në këtë ligj, më duket se po shkelet i njëjti standard kushtetues dhe ato standarde nuk duhet të vlejnë vetëm për një kategori, por për të gjitha kategoritë e zyrtarëve, që paguhen nga buxheti Republikës së Kosovës. Çështja e tretë, ka të bëjë me shqiptimin e masës disiplinore të përjashtimit të një diplomati, në këtë rast, ambasadorit nga misioni. Siç e dini, kjo kompetencë kushtetuese është e Presidentit të vendit, kurse me këtë ligji po i lejohet këtë ta bëjë ministri. Ministri nuk mund të përjashtojë një ambasador që është kryesues misioni, pa e marrë vendimin përfundimtar nga Presidenti dhe kjo bie ndesh me kompetencat kushtetuese. Andaj, propozoj tani që mos ta qesim në votim, sepse nuk është kërkuar me urgjencë të trajtohet kjo çështje. Pra, këto çështje që i përmenda, stafi ynë t'i shikojë praktikën më të mira të vendeve evropiane për shërbimin e jashtëm dhe të dalë me një raport, dhe në mbledhjen e radhës, të vendosim.

Xhavit Haliti, tha se sa i përket pagave që janë suplementare për disa institucione, nuk janë në rregull dhe për asnjë ambasadë nuk mund të vendosim fiks për pagat e tyre. E drejta për të punuar nuk i ndalohej askujt. E di që ka ambasador dhe konsull, që përveç punës së tij si ambasador, punon edhe punë tjetër. Pra, janë çështje që janë zgjedhur në forma të ndryshme, duke pasur parasysh, sepse ka ambasador që është emëruar vetëm se di anglisht apo që ka punuar për zyrat e huaja. Ky standard duhet të ndryshohet.

Nuk besoj që një person që ka punuar për një ambasadë të huaj apo ndonjë institucion të huaj, mund ta përfaqësojë Kosovën denjësisht në shërbimin që e ka.

Kur është fjala tek pagat ose tek kontakti, i kam takuar disa dhe vërtet janë skandalozë. Po ashtu, skandaloz është edhe vendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, sa i përket ambasadorëve ose ambasadave, që obligim e kanë vetëm Presidentin, Kryeministrin, ministrat dhe Kryetarin e Kuvendit, dhe realisht, janë në duar të tyre, se a duan t'ju kryejnë shërbime deputetëve ose komisioneve parlamentare.

Asnjë ambasadë nuk e informon as Komisionin për Punë të Jashtme, as Komision për Integritet Evropiane, dhe as Kryesinë e Kuvendit, për asnjë veprimtari të situatës politike në raport me Kosovën, andaj kjo çështje duhet të zgjidhet me ligj, sepse është e domosdoshme. Si po u dashka të funksionojë, pra në grupet e miqësisë, komisionet e përmendura, nëse ne nuk kemi informacion për takimet që kemi pasur, me kë të takohemi dhe cilat janë çështjet që duhet të ngrihen. Pra, nuk po dimë me kë po takohemi, sepse ndodh që takohemi me ndonjë raportues të huaj dhe ne kërkojmë ndihmë ekonomike prej tij, kurse ai ka ardhur për krejt diçka tjetër.

Duhet ta shohim diplomacinë ekonomike, cila është dhe çfarë investimesh kanë sjellë ambasadat deri më sot, të cilat shpenzojnë këtë nivel të pagave. Orientimisht dhe strategjikisht, ne kemi çalim në këtë drejtim, sepse kemi vetëm një ambasador që mbulon lindjen e mesme dhe fuqia e tij nuk mund të kryejë tërë këto punë.

Në vazhdim, tha se për mua është shqetësuese kush e emëron stafin nëpër ambasada dhe konsullata. Kemi konsullatë që janë 3 persona me titullin konsull dhe kemi ambasadë që kemi 2 ose 3 persona me titullin këshilltar. E kuptoj fillimin, por tani duhet të fillojmë që t'i qesim gjërat në vendin e vet. Ajo që Kosovës i intereson më së shumti, është që të krijojmë mundësi të investimeve në Kosovë. Kjo, deri më tani, nuk ka ndodhur që ndonjë ambasador ka sjellë ndonjë investitor në Kosovë, për t'i parë mundësitë e investimeve. Në fund, tha se për secilin punonjës,

kudo që punon nëpër ambasada, duhet pasur një raport për rezultatet e tij gjatë mandatit të parë ose të dytë dhe gradimi të përcaktohet sipas vlerësimit dhe suksesit dhe pagat të bëhen në përputhje me të.

Arben Gashi, Sa i përket amendamenteve nga Komisioni funksional për Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm, gjithçka që u tha janë faktike dhe janë probleme reale, me të cilat përballemi, por problemi është se është jashtë fushëveprimit të Komisionit tonë, andaj ne ose mund të bëjmë amendament për nenet e caktuara, ose të kërkojmë nga administrata, të bëjnë një hulumtim, dhe në bazë të hulumtimit, të bëjë amendamente konkrete për nenet specifike, përndryshe nuk kemi bazë materiale t'ia kthejmë Komisionit funksional dhe si procedurë e kemi problematike këtë punë.

Vjosa Osmani, theksoi se e di që fushëveprimin e kemi të ngushtë, por edhe më parë, si komision, kemi pasur raste që duke ndërtuar bashkëpunim të mirë me komisionet funksionale për projektligjet që nuk kanë qenë me procedurë të shpejtë, kemi dhënë vërejtje, të cilat shumë herë janë marrë parasysh. Andaj, ne ta presim raportin e stafit gjatë hulumtimit dhe t'i shohim cilat janë praktikatat më të mira evropiane, që i mbështesin këto çështje. Më e mira do të kishte qenë që të bëjmë amendamente, por edhe nëse nuk bëjmë amendamente, neve do të na ndihmojë për të vendosur që të votojmë për ose kundër, dhe në bazë të këtij raporti, mund të diskutojmë edhe në seancë dhe të mbajmë qëndrimet tona.

Bislim Zogaj, pajtohet me diskutimet e paraflësve lidhur me pagat e bashkëshortëve të ambasadorëve. Ai tha se nëse e krahasojmë me Ligjin për familjet e dëshmorëve, familja për dëshmorin e parë merr 100% të pagës, kurse për të dytin, vetëm 50%, kurse të Projektligji për shërbimet e jashtme, bashkëshortet e ambasadorëve, të pagohen 50% të pagës së atashut, pa punuar, duke ndenjur në shtëpi, konsideroj se kjo është e papranueshme, andaj pajtohem që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës për mbledhjen tjetër.

Kujtim Paqaku, pajtohet me diskutimin e znj. Vjosa, e cila tha se Kosova ka problem me buxhet për barna esenciale dhe me buxhet për shumë kategori tjera dhe në momentin kur ballafaqohemi me varfëri të skajshme të ju pagohen bashkëshorteve të ambasadorëve paga pa punuar, por në këtë rast tha se nuk do të flisja në mënyrë gjenerale, sepse kam pas rast që jam takuar me ambasadorin në Berlin dhe ambasadorin në Hungari, i cili nuk mund të i shkolloj fëmijët e vet me pagën që e merë, mos të gjeneralizojmë për të gjithë, sepse me tepër mund të ju jepja aksent punës së ambasadorëve në punët konsulare për rregullimin e dokumenteve të qytetarëve tanë.

Vjosa Osmani, tha se unë nuk fola për profesionalizmin e ambasadorëve tanë, por fola vetëm për privilegjet e familjeve të tyre. Jam për pagesë të shkollimit të fëmijëve pagesës së shërbimit shëndetësor dhe këtu nuk po flasim me ju mohu të drejtën në punë të bashkëshorteve të tyre.

Arben Gashi, vlerësoi se ose duhet gjetur një vend ku duhet kundërshtuar, ose të kërkojmë për lexim të tretë, sepse në seancë nuk mund të flasim për çështjet financiare dhe kushtetuese.

Vjosa Osmani, edhe një herë propozoi që së pari të bëhet hulumtimi dhe t'i shikojmë praktikatat e shteteve tjera, e pastaj të vendosim. Ajo theksoi se ekziston një vendim i Gjykatës për të drejtat e njeriut, që i përket privilegjeve. Ne e kemi për detyrë t'i marrim parasysh vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës Kushtetuese.

Luljeta Veselaj Gutaj, tha se jemi në fazat fillestare të diplomacisë dhe na duhet eksperiencë. Ne mund të bëjmë amendament dhe të shprehim në seancë vërejtjet tona, por nuk e di sa kemi hapësirë të ndikojmë për ndryshimin e këtij ligji.

Slobodan Petrović, tha se ne jemi që ky projektligj të jetë në përputhje me legjislacionin e BE-së, andaj le të angazhohet administrata që ta bëjë hulumtimin dhe të dalë me një raport, në mbledhjen e radhës.

Pas diskutimeve të anëtarëve, kryesuesi i mbledhjes konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 05/L-061 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional, shtyhet për shqyrtim për në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesi lidhur me këtë projektligj, paraqiti opinionin ligjor.

Çështjet e rregulluara dhe të adresuara në këtë projektligj, nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Pra, shtetet anëtare të BE-së, këtë fushë e rregullojnë sipas politikave dhe legjislacionit të tyre të brendshëm.

Andaj, ftoj anëtarët e Komisionit, që nëse nuk kanë ndonjë vërejtje, me ngritje dore të deklarohen për këtë projektligj.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, dhe si i tillë, mund të procedohet në Kuvend për miratim.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-055 për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesi njoftoi se Komisioni ynë ka shqyrtuar edhe një herë këtë projektligj, me raportin e Komisionit funksional, por ndërkohë, Komisioni funksional na ka riproceduar edhe një herë raportin, me disa plotësime. Në vazhdim, paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj.

Pas verifikimit dhe shqyrtimit, konstatojmë se Projektligji nr. 05/L-055 për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Andaj, ftoj anëtarët e Komisionit, që nëse nuk kanë ndonjë vërejtje, me ngritje dore të deklarohen për këtë projektligj.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Rekomandim

Projektligjit nr. 05/L-055 për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së, dhe si i tillë, mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesi lidhur me këtë projektligj, paraqiti opinion ligjor.

Projektligji për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, me amendamentet e Komisionit funksional, janë shqyrtuar dhe pasi është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Andaj, ftoj anëtarët e Komisionit, që nëse nuk kanë ndonjë vërejtje, me ngritje dore të deklarohen për këtë projektligj.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Rekomandim

Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt, në Kuvend.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesi lidhur me këtë projektligj, paraqiti opinion ligjor.

Pas verifikimit dhe shqyrtimit, konstatojmë se Projektligji nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, pasi që në nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e primar dhe sekondar të BE-së, dhe nuk është e rregulluar në mënyrë specifike me Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Andaj, ftoj anëtarët e Komisionit që nëse nuk kanë ndonjë vërejtje, me ngritje dore të deklarohen për këtë projektligj.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt, në Kuvend.

8. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë, nuk u ngrit asnjë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zëvendëskryetar i dytë i Komisionit,

z. Slobodan Petrović
